6.1.3. Akuiferi karstik

Akuiferi karstik në zonën Parkut Kombëtar,,Bjeshkët e Nemuna” përfshinë sipërfaqe prej $292,40 \text{ km}^2$ ose 46,41%, të hapësirës së parkut. Shtrihet në verilindje, perëndim dhe veriperëndim (Bjeshkët e Pejës, Maja e Hasanit, Rusolia, Zhlebit, Mokna, Qakorr etj.). Në aspektin hidrogjeologjik, gëlqerorët dhe mermeret që përbënë këtë akuifer, karakterizohen me sasira të konsiderueshme të ujrave nëntokësorë që formojnë akuifere karstike. Gëlqerorët janë mjaft të karstifikuar dhe dallohen nga forma karakteristike (kanale, kaverna, shpella etj), çka ka kushtëzuar formimin e rezervuarve të mëdhenj të ujrave nëntokësorë. Regjimi i burimeve karstike është i lidhur ngushtësish me regjimin e reshjeve. Burimet me prurje të qëndrueshme dhe të madhe zakonisht janë në numër të vogël. Këto burime dalin në prerjet erozionale të shkëmbinjve karbonatikë - luginat e lumenjve, ose në kontaktet e gëlqerorëve me formacionet shistozë apo flishoidalë të papërshkueshme, në nivele të ulëta hipsometrike. Prurjet e këtyre burimeve luhaten nga 10-2000 l/s (*IHMK, 2010*). Karakteristike e veçantë e burimit të tipit karstik është amplituda e madhe e luhatjes së prurjes. Duke u nisur nga karakteristikat e përgjithshme gjeologjike dhe hidrogjeologjike dhe pozicionit hapësinor ku paraqitenakuferët karstikë në zonën e parkut, konstatohet se ky tipakuferi ushqehet kryesisht nga reshjet atmosferike. Tip iakuiferit karstik paraqetakuferin më të rëndësishëm sa i takon ujërave nëntokësorë në zonen e Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna”. Sot nga burimet e ujit që dalin nga kyakufer furnizohen me ujë të pijshëm shumë vendbanime brenda dhe jashtë zonës së Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna”. Valorizimi ekonomik dhe shfrytëzimi racional i ujit nga kyakufer do ta rriste vlerën jo vetëm të parkut por edhe të rrethinës.

6.1.4. Akuifer me ujëmbajtje të dobët

Ka përhapje mjaftë të madhe në hapësirën e parkut prej; $291,47 \text{ km}^2$ ose 46,26% të hapësirës së parkut. Shtrihet në gjithë anët e parkut, por kryesisht në pjesën perëndimore, jugore dhe juglindore. Në aspektin litologjik janë të ndërtuara nga formacionet e Paleozoikut të përfqaqësuara me: rreshpet, rreshpe epidotike, filite, shiste, ranor, meta-konglomerate, meta-gabro,

diabaze, meta-bazalte, serinë metamorfike, porfiridet, strallore, diabazat, seria strallore, shkëmbinjtë magmatik, flish, si dhe seritë të ngjashme me to, të cilat sipas veteve të tyre hidrogeologjike paraqiten si izolator hidrogeologjik.

6.2. Burimet e ujërave nëntokësorë

Burimet e ujërave nëntokësorë paraqiten pothuajse në gjithë sipërfaqen e parkut, por dendësinë më të lartë e kanë në formacionet karbonatike (Fig.7.).




Fig.7. Shpërndarja e burimeve të ujit në zonën e parkut (**Foto:** Burimi karstik i Radavcit)

Bazuar në të dhënrat ekzistuese brenda kufirit të parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna“ ekzistojnë rreth 730 burime të ujërave nëntokësorë. Prurjet e ujit luhatet nga 0,10 deri në 2400 l/s. Vlera e pH luhatet nga 5 deri në 7 (Enti për



Hidroekonomi i Shkupit, 1983). Në bazë të përbërjes litologjike si dhe tipeve të porozitetit e ujëpërshkushmërisë janë dalluar këto tipe të burimeve:

1. Tipi shtresor
2. Tipi çarës
3. Tipi karstik

6.2.1. Tipi shtresor

Ky tip i burimeve është zhvilluar në formacionet gjeologjikë me porozitet intergranular si zhavorr-rëra dhe analoget e tyre të diagjenezuar, me shkallë kompaktësimi të ndryshme.

Burimet e këtyre ujérave kanë përgjithësisht lidhje hidraulike me ujërat sipërfaqësore dhe për këtë arsy, regjimi i burimit, temperatura dhe përbërja kimike e ujérave nëntokësorë është në varësi të parametrave respektivë të ujérave sipërfaqësorë. Meqenëse ky tip i burimeve ka përhapje relativisht të madhe, paraqet rendësi në aspektin e mundësisë së shfrytëzimit të ujit.

6.2.2. Tipi çarës

Ky tip i burimeve është i përhapur në shkëmbinjtë e Paleozoikut, serpentinitet e peridotitet dhe formacione e Neogenit. Këta shkëmbinj janë të alteruar në shkallë të ndryshme dhe kanë të zhvilluar një sistem rrjetor të plasave dhe çarjeve, me lidhje hidraulike përgjithësisht të mira ndërmjet tyre. Ato karakterizohen me prurje të ndryshueshme dhe varen nga densiteti i çarjeve dhe gjërësia e çarjeve. Këto burime, për shkak të rrjedhjes së shpejtë të ujit nëpër çarje, kanë luhatje të theksuar të prurjeve në varësi nga reshjet atmosferike (*Dakoli, 2007*). Burimet e çarjeve kanë ujëdhënie të vogël prej 0.1 – 1 l/s dhe shumë rrallë deri në 10 l/s.

6.2.3. Tipi karstik

Burimet karstikë lidhen kryesisht me gelqerorët në të cilët janë të zhvilluara intensivisht dukuritë karstike (*Dakoli, 2007*). Nga aspekti hidrogjeologjike masivët gëlqerorë karakterizohen me infiltrim të lartë. Ato kanë ujëpershkueshmeri të lartë dhe magazinojnë në boshllëqet e tyre sasi të konsiderueshme ujtrash nëntokësorë. Karakterizohen me burime me prurje të mëdha, që luhaten nga 20-100 l/s deri në $10 \text{ m}^3/\text{s}$. Karakteristikë e veçantë e burimeve të tipit karstik është amplituda e madhe e luhatjes së ujëdhënieve se tyre përgjatë vitit. Zona e parkut është pjesa më e pasur e basenit të Dukagjinit me burime ujore karstike nga të cilat sot furnizohen me ujë të pijshëm shumë vendbanime të kësaj zone, ose shfrytëzohet për ujitje dhe gjenerimin e energjisë elektrike.



PËRFUNDIME

Parku Kombëtar, me sipërfaqe prej 63.027.75 ha, ndodhet në pjesën perëndimore të basenit të Dukagjinit. Prajet një ndër masivet malore më atraktive dhe më të bukura të Republikës së Kosovës. Veçoritë morfogjentike të reliefit, rrjetit hidrografik, hidrogeologjik etj., janë të larmishme dhe janë produkt i orogjenezës apline. Dallohen katër tipe gjenetike të reliefit: tipi i reliefit eroziv, tipi i reliefit karstik, tipi i reliefit akullnajor dhe tipi i reliefit lumor. Elementin gjeomorfologjik më të rëndësishëm e paraqesin; Gryka e Rugovës. Takohen të gjitha format karstike; plasa, çarje, kaverna, gropë, shpella etj. Në zonën e parkut dominon klima mesdhetare kontinentale dhe malore të ndërthurura me mikroklimat të kushtëzuara nga alternimi i luginave lumore me malet e larta ç'ka çon në modifikime të ndryshme të klimës mesdhetare dhe kontinentale. Temperaturat mesatare mujore luhaten nga -0,33°C deri 21,37°C, stacioni Pejë dhe stacioni Istog nga 0,3°C deri 20,8°C. Reshjet mesatare vjetore luhaten nga 650 mm (pjesa fushore) deri mbi 1400 mm (pjesa malore). Rrjeti hidrografik është mjaftë i zhvilluar. Lumenjtë kryesor janë: Lumbardhi i Pejës, Deçanit, Lloqanit dhe lumi Erenik.

Formacionet gjeologjike u takojnë moshave nga Paleozoiku deri në Kuaternar. Triasiku përfaqësohet kryesisht nga gëlqerorë dhe dolomite, me trashësi mbi 600 m, të cilat janë formuar në kushte sedimentimi të qetë. Formacionet gjeologjike të Paleozoikut janë të larmishme dhe përfaqësohen nga rreshpe, kuarcite, ranorë, gëlqerorë, grauvakë dhe konglomeratë. Rreshpet përfaqësohen nga argjiloshistet, filitet, mikashistet, rreshpet albit-sericitike, albit-kloritike, shkëmbinjtë aktinolitikë, si dhe kuarc-konglomerate të metamorfizuara. Triasiku i Poshtëm dhe i Mesëm përfaqësohet nga seria vullkanogjeno-sedimentare, me thjerëza të gëlqerorëve e dolomiteve, pastaj me serpentinite, diabaze, granite dhe kuarcporfire dhe Kuaternari përfaqësohet me depozitime aluviale, deluviale, glaciale dhe fluvioglaciale, të përhapura në luginë lumore dhe shapte.

Në zonën e Parkut Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna” janë dalluar katër tipe akuferesh kryesore:

- Akuiferi me porozitet intergranular
- Akuiferi me porozitet plasa-çarje
- Akuiferi karstik
- Akuifer të dobët ujëmbajtës

Në bazë të përbërjes litologjike si dhe tipeve të porozitetit e ujëpërshkushmërisë janë dalluar këto tipe të burimeve:



- Tipi shtresor i burimeve, i zhvilluar në shkëmbinjtë me porozitet intergranular si zhavore-ranorë me shkallë kompaktësimi të ndryshme.
- Tipi i çarjeve, është i përhapur në shkëmbinjtë e Paleozoikut, serpentinitet e peridotitet dhe formacione e Neogenit, të cilët karkterizohen me intenzitet të ndryshem të alterimit.
- Tipi karstik i burimeve, që lidhen kryesisht me gëlqerorët në të cilët zhvillohen intensivisht dukurite karstike. Karakterizohen me ujëpërshkueshmëri të lartë dhe magazinojnë në boshllëqet e tyre sasi të konsiderueshme ujtrash nëntokësorë.

Mbrojtja e vlerave të natyrës dhe menaxhimi i integruar i tyre brenda zonës së Parkut do të paraqet një nga elementet më të rëndësishme në planifikimin e qëndrueshme të Parkut dhe valorizimin e tij.

REFERENCAT

- Ahmetaj I., 1980.** Gjeomorfologjia e Sharrit dhe Brezovicës, Revista Shkencore Përparimi, Prishtinë, nr.4, 527-552.
- Antonijeviq R, Paviq J, Karoviq J, Menkoviq L, 1978.** Teksti sqarues i hartës gjeologjike 1:100000, Plansheti K34-53 Pejë dhe K-34-65, Kukës, Beograd (faqe 6).
- Ahmetaj I., 1977.** Furnizimi me ujë dhe shpërndarja e ujërave nëntokësore në Kosovë, Revista Shkencore Përparimi, Prishtinë, nr.1, 67-81.
- Antonijeviq I., Karoviq J., Paviq., 1968.** Harta gjeologjike plansheti Pejë (1:100000), Beograd.
- Cadraku H. & Beqiraj A. 2013.** Veçoritë Hidrogjeologjike të Basenit të Dukagjinit, Kosovë. Bul. Shk. Gjeologjike. Nr.1, 53-66.
- Çukiq D, 1979.** Këshillimi mbi parqet nacionale dhe regionale të Jugosllavisë, Brezovicë, 111-124.
- Dakoli H., 2007.** Hidrogjeologjia, ISBN 978-99943-974-9-5, Tiranë
- Dakoli H., Xhemalaj Xh., 1997.** Hidrogjeologjia, Tekst Universitar, SHBLU, Tiranë.
- Dakoli H., 2007.** Hidrogjeologjia I, Biblioteka e FGJM, Tirane, 260 faqe.
- Dulli S., 1983.** Studime meteorologjike dhe hidrologjike, Tiranë, 182 faqe.
- Eftimi. R., Tafilaj I., Bisha G. 1989.** Rajonizimi hidrogjeologjik i Shqipërisë. Buletini i Shkencave Gjeologjike, p. 303-316, Nr. 4.
- Elezaj Z., Kodra A., 2008.** Gjeologjia e Kosovës, Tekst Universitar – Katalogimi në botim CIP, ISBN 978-9951-00-068-0, Prishtinë
- Enti për Hidroekonomi i RSM-Shkup, 1983.** Kadastri i Burimeve dhe Kadastri i Ujësjelleseve, Prishtinë.



Fang Zh. H., Zena K., 2010. Projekti përkrahje Institucionale për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Autoritetet e Pelliqeve Lumore, 2008-2010. Raporti Teknik për Hidrologji të PELLGUT LUMOR të Drinit, Prishtinë, 1-67.

Gruda Gj., 2003. Gjeomorfologjia. SHBLU, Tiranë, 397 faqe

Grup autorësh., 1983. Gjeologjia e Shqipërisë. Monografi e Hartës Gjeologjike 1:200 000.

Grup autorsh., 1981. Gjeologjia e Serbisë III1, Magmatizam, Beograd, 127-206.

Çavolli R., Gashi M., 1979. Këshillimi mbi parqet nacionale dhe regionale të Jugosllavisë, Brezovicë.

Instituti për Hidroekonomi (IH), „Jarosllav Ćerni” 1983. Pasqyra e Bazës së Hidroekonomisë së KSA të Kosovës'. Prishtinë.

Kazazi M., 1983. Studime meteorologjike dhe hidrologjike, Tiranë, 124-145.

Komatina M., Gjakoviq J., 1975. Bilanci i Ujërave Nëntokësorë, Beograd, 54-55.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) 2006. Harta gjeologjike 1:200.000, Prishtinë.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) 2006. Harta hidrogjeologjike 1:200.000, Prishtinë.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) 2006. Harta morfoortografike 1:200.000, Prishtinë.

Labus D., 1979. Kërkime Gjeografike, Bilanci i ujor i pellgut të lumit Drini i Bardhë, Prishtinë, 107-123.

Markoviq S., Dobruna I., 1979. Parqet Nacionale dhe Regionale të Jugosllavisë, Prishtinë 133-140.

Mekshiqi N., Hoxha J., Kodra A., Dardha M., Hysenaj R., Hoxha V., Fejza I., Avdullahu S., Meha M., Çadraku H., Sahiti F., Dardha A., 2009. Korelimi i hartës gjeologjike zonës kufitare Kosovë – Shqipëri 1:50000, Planshetet: K-34-53-A, K-34-53-C, K-34-65-B, K-34-66-A, K-34-66-C, K-34-78-A, Prishtinë

Menkoviq Lj., 1995. Morfologjia sipërfaqësore e karstit të Moknës dhe Zblebit, Beograd, 250 faqe.

Micevski E., Zhogorski G., 1983. Raport i hulumtimeve hidrogjeologjike në Istog–Institut Gjeologjik i Shkupit.

Pano N., 2008. Pasuritë Ujore të Shqipërisë. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 482 faqe.

Pasha H., 1975. Natyra e Kosovës, Vetitë fiziko gjeografike të ujëmbledhësit të Drinit të Bardhë, Prishtinë, 131-149.

Peric J., etj., 1978-1979. Projekti detal i hulumtimeve hidrogjeologjike për përcaktimin e kushteve për ndërtimin e akumulacionit nëntokësorë në Istog, Fakulteti i xehetarisë dhe Gjeologjisë, Beograd.



Peric J., 1978. Studimi për mundësin e akumulimit të ujërave nëntokësorë në basenin e Dukagjinit – Beograd.

Pllana R., 1991. Kërkime Gjeografike., Prishtinë, 51-58.

Popovic K., 1978. Gjeologjia Serbisë VIII-2, Gjeologjia Inxhinerike, Beograd.

Premiere Urgence, Aide Humanitaire Internationale, 2000-2001: “Water Supply Server in Rural Areas, Kosovo.

Selenica A., 2009. Hidrologjia Inxhinerike, Tiranë 395 faqe

Popoviq S. 1985. Ndërtimi i hartës bazë hidrogeologjike fleta Pejë 51/3,4; 52/3,4 sekcionet Bogiqevica, Gjeravica, Deçan dhe Baranë 1:25000, Beograd.

Talani R., 2000. Morfologjia dhe Morfometria e Luginave në Alpet e Shqipërisë, Monografi Shkodër, 3-95.

Vilimonoviq J., 1973. Studimet regionale hidrogeologjike në Kosovë, Fondi i Gjeozavodit - Beograd.

Universiteti Amerikan në Prishtinë, 2009. Programi ArcGIS®9, ArcView®9.2, Windows® Single Use, 180 Day trial GIS software for students and educators. Evaluation registration code EVA 861053408, MADE IN USA 105675.



ZHVILLIMI I KONCEPTEVE MBI HARTAT DHE HARTOGRAFINË

(DEVELOPMENT OF CONCEPTS ON MAPS AND
CARTOGRAPHY)

Pal NIKOLLI¹, Bashkim IDRIZI², Ismail KABASHI³

PËRMBLEDHJE

Sot, hartografia moderne përfshin një radhë të gjerë aplikacionesh të tilla si harta dixhitale, produkte të hartografimit dixhital, format alternative të vizualizimit dhe analizën e të dhënave digitale gjehapësinore. Ajo trajton edhe zhvillimin e një kornize teorike/konceptuale që shpjegon proceset e ndryshme të hartografimit.

Ky punim është një analizë e disa koncepteve teorike bashkëkohore në lidhje me hartën dhe hartografinë. Për shkak të aspektit metodologjik, analiza konceptuale e hartografimit është shumë e rëndësishme dhe prandaj është trajtuar edhe nga Komisioni ICA në hartografimin teorik për shumë vite.

Një hartë mund të prodhohet në tre formate të ndryshme: si kopje fizike (harta letër, shtyp plastike), gjeo - dataset digitale (hapësinore ose / dhe hartografike) dhe vizualizim hartografik i të dhënave nga baza e të dhënave gjeografike (prezantim i hartës multimedia). Një nga qasjet më të dobishme në studimin e hartografisë është përcaktimi i hartave si një formë e komunikimit vizual - një gjuhë e qëllimit të veçantë për pëershkrimin e marrëdhënieve hapësinore. Modelet e ndryshme strukturore e pëershkruanë hartografinë si një shkencë, disiplinë akademike, teknologji dhe art.

Fjalët kyqe: hartë, hartimi dixhital, hartografi, konceptet mbi hartat, konceptet mbi hartografinë

ABSTRACT

Today, modern cartography includes a broad range of applications such as digital maps, digital mapping products, alternative forms of visualization and analysis of

¹ **Dr. Pal NIKOLLI**, e-mail: palnikolli@yahoo.com

Tirana University, Faculty of History and Philology, Tirana, Albania. www.fhf.edu.al

² **Dr. Bashkim IDRIZI**, e-mail: bashkim.idrizi@unite.edu.mk

State university of Tetova, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, www.unite.edu.mk

³ **Dr. Ismail KABASHI**, e-mail: ikabashi@gmx.net

University of Prishtina, www.uni-pr.edu; Prishtina, Kosova



digital geospatial data. It addresses the development of a theoretical/conceptual framework that explain various mapping processes.

This paper is an analysis of some contemporary theoretical concepts about the map and cartography. Due to methodological aspects, conceptual analysis of the mapping is very important and therefore is treated by the ICA in mapping theory for many years.

A map can be produced in three different formats: as a hard copy (paper maps, press plastic), geo - digital dataset (spatial and/or mapping) and cartographic visualization of data from geographic database (map multimedia presentation). One of the most useful approaches to the study of cartography is the definition of maps as a form of visual communication - a special purpose language for describing spatial relationships. Different models describing structural mapping as a science, academic discipline, technology and art.

Key words: map, digital mapping, cartography, concepts about maps, concepts about cartography

1. KUPTIMI I SOTËM MBI HARTËN

Çuditërisht, kjo është një pyetje për të cilën nuk ka një përgjigje të lehtë. Ne të gjithë "e dimë" se çfarë është një hartë, por përkufizimi i saj mund të ndryshojë nga personi në person dhe kultura në kulturë. Një përkufizim i përgjithshëm, rreth 40 vjet më parë ka qenë: "Një përfaqësim grafik⁴ i të gjithë ose një pjese të sipërafares së Tokës e vizatuar në shkallë mbi një plan". Megjithatë, pas këtij përkufizimi u gritet disa pyetje: Po në lidhje me Hënën dhe veçori të tjera jashtëtokësore, çfarë mund të themi? Në qoftë se kjo duket si një hartë, por i mungon një tregues i shkallës së saj, a është ajo një hartë? A mund të konsiderohet hartë një imazh satelitor me shënimë (me emrat e veçorive të shtypura në të)? A është globi një hartë? Po në lidhje me përfaqësimet 3-D, çfarë mund të themi? Puristët⁵ do të thoshin se një "hartë" pa shkallë është një diagram dhe se përfaqësimet 3-D janë modele. Hëna dhe planetet mund të trajtohen duke futur "ose trupa të tjerë qellor" në përkufizimin bazë të hartës.

Është vërejtur se disa kultura jo-perëndimore kanë bërë përfaqësime apo paraqitje të objekteve e dukurive që nuk përshtaten me përkufizimin

⁴ Harta është një paraqitje grafike e të gjitha aspekteve të mjedisit kulturor dhe fizik. Ky përkufizim përfshin abstraksionet mendore që nuk janë fizikisht të pranishme në peizazhin gjeografik (është e mundur, për shembull, të hartografohet edhe qëndrimi i njerëzve).

⁵ Purist është ai individ i cili dëshiron që një objekt të mbetet i vërtetë për thelbin e tij dhe i lirë nga fallsifikimet ose ndikimet pa vlerë.



"zyrtar", por që ende funksionojnë si harta. Gjithashtu, duhet të vemë në dukje se ka edhe harta gojore, harta mendore, dhe harta të performancës. Atëherë shtrohet pyetja: Ku përshtaten këto në përkufizimin e dhënë?

J.H. Andrews, në një artikull të vitit 1996, ka mbledhur 321 përkufizime mbi "hartën" të përcaktuara në vitet 1694-1996 (Andrews, 1996). Ne zakonisht përdorim përkufizimin e bërë nga ICA (Shoqata Ndërkombëtare Hartografike) në vitin 1995, por që sipas faqes Maphist (<http://www.maphistory.info/>), ky përkufizim është me origjinë nga një burim më i hershëm: "Një imazh i simbolizuar i realitetit gjeografik, që përfaqëson/paraqet veçoritë apo karakteristikat e zgjedhura, që rezultojnë nga përpjekjet krijuarë të hartografëve, dhe të dizajnuara për përdorim kur marrëdhëniet hapësinore janë me rëndësi të veçantë (Wood, 1993)".

Me vlerë është dhe përcaktimi i dhënë në Fjalorin e Gjeografisë Humane: "Harta imazh është një përfaqësim i strukturuar hartografik i informacionit të përzgjedhur hapësinor. Imazhi bëhet një hارتë kur përfaqësohet/paraqitet fizikisht (p.sh. harta topografike klasike, etj), virtualisht/praktikisht (p.sh. në një ekran kompjuteri) ose në formën gjuhësore (p.sh. udhëzime hapësinore me gojë ose me shkrim)" (Johnston, 1994).

Natyrisht, kjo temë është debatuar pafundësisht në seminare, konferanca, dhe nëpër mjedise shkencore. Për qëllim të këtij punimi ne do të përdorim përkufizimin funksional të hartës, të dhënë nga ICA. Shkurtimisht ne do ta përcaktojmë hartën si "një përfaqësim grafik që tregon marrëdhënie hapësinore"⁶.

Një paraqitje hartografike, në një masë të madhe, varet nga përdorimi i parashikuar i hartës. Objektivi kryesor i hartave është për të ruajtur informacionin gjeografik në një format hapësinor, zakonisht dy-dimensional. Një tjeter arsyе e krijimit të hartave mund të jetë qëllimi analistik që përfshinë matjet dhe llogaritjet. Qëllime të tjera të krijimit të hartave kanë të bëjnë me përbledhjen e të dhënavë statistikore voluminoze për të ndihmuar në parashikimin hapësinor dhe trendet e diktuarë. Ndonjëherë hartat përdoren, thjesht, për të vizualizuar fenomene abstrakte të cilat, ndryshe do të ishin të padukshme.

Prodhimi i një harte përfshin një transformim matematik të disa pjesëve të botës reale në një format të gjeneralizuar, përfaqësues dhe pikturë. Ky përfaqësim mund të bëhet në formatin analog (hartën letër) ose / dhe digital

⁶ Përcaktimi zyrtar i hartës është: Një hارتë është një imazh i simbolizuar i realitetit gjeografik, që paraqet veçori apo karakteristika të zgjedhura, që rezultojnë nga përpjekjet krijuarë të veprimitarisë të autorit të saj të zgjedhjes, dhe është projektuar për përdorim kur marrëdhëniet hapësinore janë të një rëndësie parësore. (Shoqata Ndërkombëtare Hartografike 1996, fq. 1)



(hartë kompjuter). Produktet nga të dy dy drejtimet përfshijnë një proces vizualizimi hartografik. Një hartë mund të prodhohet në tre formate të ndryshme: si kopje fizike (harta letër, shtyp plastike), gjeo - dataset digitale (hapësinore ose / dhe hartografike) dhe vizualizim hartografik i të dhënave nga baza e të dhënave gjeografike (prezantim i hartës multimedia).

1.1. Karakteristikat e hartave

Të gjitha hartat kanë të bëjnë me dy elemente themelore të realitetit nga të cilat mund të formohen shumë marrëdhënie hapësinore. Elementi bazë është vendndodhja hapësinore që mund të përfaqësohet/paraqitet në një hapësirë dy, tre, apo katër përmasore; çdo numër atributesh mund të bashkëngjitet në atë vend hapësinor. Harta tradicionale letër i përshkruan pozicionet në një projekcion dhe sistem koordinatash të paracaktuar. Teknikat e simbolizimit përdoren për të treguar atributet nëpërmjet variablate vizuale (p.sh. madhësia, ngjyra, modeli, etj). Hartografimi dixhital mund të përdorë çdo projekcion dhe sistem koordinativ në dispozicion për vizualizimin hartografik dhe mund të marrë atributë që disponohen në vend nga një bazë të dhënash të lidhura dhe në mënyrë përsëritëse përdor teknika të shumta vizualizimi. Hartografia dixhitale ka më shumë mundësi për vizualizim shkencor, i cili përfshin jo vetëm paraqitjen e informacionit grafik, por edhe efektin e saj tek shikuesit.

Të dy llojet e hartave, tradicionale dhe dixhitale, trashëgojnë tri veti kryesore:

- Të gjitha hartat janë transformime matematikore të realitetit (fig. 1.4.1). Shumica e hartave kanë bazën matematike:
 - ✓ *Shkalla* – Marrëdhënie e përcaktuar përmasore ndërmjet realitetit dhe hartës
 - ✓ *Projekzioni i hartës* - një transformim i sipërfaqes sferike në një sipërfaqe të sheshtë. Me përjashtim të planeve topografike, që nuk përdorin projeksionet, ato janë përfaqësime planimetrike të realitetit në shkallë.
 - ✓ *Elipsoidi* - model i sipërfaqes sferike
 - ✓ *Sistemet e koordinatave* - një pikënisje dhe sistem i matjeve
 - ✓ *Datum* - një kornizë e referencës për matjen e pozicioneve në sipërfaqen e tokës
 - ✓ *Rrjeti gjeografik apo / dhe rrjeti koordinativ/kilometrik*




Fig. 1.4.1. Një hartë është transformim matematik i realitetit

- Të gjitha harta përdorin simbolizimin për paraqitjen e realitetit (fig. 1.4.2). Ato përdorin simbolet (shenjat) ose / dhe tekstin për të përfaqësuar subjektet/entitetet e botës reale:
 - ✓ Shpesh përdoren lloje të ndryshme të simboleve, të tilla si linjat, pikat, ngjyrat, tonalitet, modelet, etj
 - ✓ Elementet e projektimit/vizatimit të hartës bazohen në një sërë parimesh
 - ✓ Hartografia tematike përdor teknika (metoda) simbolizimi për prezantimin e pikës, linjave, poligoneve dhe sipërfaqeve



Fig. 1.4.2. Hartat përdorin simbolizimin për paraqitjen e realitetit (burimi: Web of Sony in Japanese)

- Të gjitha harta janë abstraksione të realitetit (fig. 1.4.3). Imazhet botërore i nënshtrohen një vërtetësie të operacioneve të përgjithësimit, të tilla si përzgjedhja, thjeshtëzimi, klasifikimi, bashkimi etj. Llojet e përgjithësimit janë:
 - ✓ Përgjithësimi bazuar në model - transformime gjeometrike të subjekteve/entiteteve reale me qëllim të përfaqësimit të tyre në bazat e të dhënave dixhitale

- ✓ Përgjithësimi bazuar në objekt - transformime gjeometrike të objekteve të bazave të të dhënave digitale me qëllim të përfaqësimit të tyre në shkallë të ndryshme
- ✓ Përgjithësimi hartografik - transformime grafike për qëllime vizualizimi dhe prodhimin e hartës



Fig. 1.4.3. Një hartë është përgjithësim i realitetit

Hartat dixhitale trashëgojnë të njëjtat karakteristika, por me disa veçori. Në të vërtetë hartat digitale kanë dy paraqitje: e para është baza e të dhënave dhe e dyta është hartografike ose vizuale. Përfaqësimi/paraqitja e bazës së të dhënave është një model dixhital i realitetit. Ai mund të jetë, për shembull, një model gjeo - relacional i përfaqësimit/paraqitjes vektor dhe / ose raster. Përfaqësimi hartografik dixhital përfshin modelimin grafikisht të realitetit. Kjo paraqet përfthimin e objekteve grafike nga baza e të dhënave. Kështu, për të përfthuar përfaqësimë dixhitale hartografike duhet të zbatohen dy hapa të përgjithësimit. Këto hapa janë: përgjithësimi me bazë modelin - abstragim i realitetit, për të krijuar modelin e bazës së të dhënave të tij dhe përgjithësimet hartografike që përcjellin një qartësi të hartës. Hartografia dixhitale ka futur simbologji të re, teknika të përfaqësimit/paraqitjes dhe variabla vizuale (p.sh. frekuencën, transparencën, etj) për vizualizimin hartografik. Megjithatë, *në thelb çdo hartë mbetet përfaqësim simbolik i realitetit, qoftë kur shfaqet në formë të shtypur ose nëpërmjet multimedias..*

2. HARTOGRAFIA DHE KUPTIMI I SAJ

Hartografia është një nga shkencat më të lashta. Gjatë mijëra viteve të ekzistencës së saj, për shkak të punës kërkimore të shumë shkencëtarëve, ajo ka fituar një numër shkollash. Në rrjedhën e kohës secila prej tyre ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Tani është koha për të kërkuar



mënyra të reja më të përparuara të zhvillimit të hartografisë të cilat do të ishin të shquara për përsosjen e tyre, thjeshtësinë relative dhe disponueshmërinë.

Në vitin 1949 hartografia është njojur zyrtarisht si një shkencë e pavarur (dokumente të OKB-së, I, 19, fq. 8 - UN Documents, I, 19, p. 8). Por kur hartografia u konsiderua si një shkencë, ishte e rëndësishme të identifikohej se çfarë lloji shkence është ajo (shkencë bazë, shkencë e aplikuar, shkencë natyrore, shkencë sociale); cilat janë karakteristikat dhe parimet e saj, konceptet dhe postulatet dhe a janë këto të vërteta apo të nxjerra nga shkenca apo disiplina të tjera.

Atëherë, natyrshëm shtrohet pyetja: çfarë është hartografia? Ekzistojnë disa përkufizime për hartografinë⁷. Kështu, ka përkufizime tradicionale ("klasike") të cilat e përshkruajnë atë si një shkencë, art dhe teknikë për krijimin e hartës. Teknika nënkuption mënyrën për të gjeneruar produkte hartografike të sakta në formatin analog ose dixhital. Aspekti i artit në thelb ka të bëjë me kontekstin kulturor dhe historik ku hartat shprehin më shumë se vetëm elementet objektive të peizazhit (Cartwright et al. 2008). Në anën tjetër, në fillim të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, kur hartografët filluan t'i përqëndrojnë hulumtimet e tyre në hartografi, përkufizimi shkencor i hartografisë u drejtua nga konteksti i saj disiplinar, i formuluar fillimisht në librin kulmor "The Look of Maps" të Arthur Robinson, botuar në vitin 1952 (Montello, 2002).

Lidhur me aspektin teorik të hartografisë, Koch (2002) referohet në progresin dhe zhvillimin shkencor të disiplinës që nga vitet 1970, duke përmendur hartografinë teorike ose teorinë e hartografisë. Nën këto tema natyrisht bien "teoritë hartografike" të zhvilluara nga autorë të tillë si Aslanikashvili, Ratajski, Freitag dhe Ogrissek.

Për këto arsy, hartografia konsiderohet si një disiplinë shkencore relativisht e re në krahasim me shkencat fizike, të cilat janë zhvilluar gjatë shekullit të 17 dhe 18, apo shkencat sociale, të cilat janë zhvilluar në shekullin e 19-të (Sluter, 2001). Për një studim epistemologjik të disiplinës është e arsyeshme të marrin në konsideratë evoluimin e shkencës kryesore mëmë të hartografisë, gjeografisë. Gjeografia ka qenë disiplina më e afërt në krijimin e hartave, nga fillimet e saj të hershme në periudhën latine, Mesjetë, Rilindje

⁷ Disa nga përkufizimet/përcaktimet e hartografisë të përdorura në kohë të ndryshme janë: "Një process abstraktioni në të cilin përgjithësohen ose thjeshtohen veçoritë e botës reale për të përbushur kërkuesat e temës dhe audiencës"; "Formë e komunikimit visual - një gjuhë për qëllime të veçanta që përshkruan marrëdhëniet hapësinore"; "Përdorimi i burimeve vizuale të tillë si ngjyra, forma dhe modeli për të komunikuar informacion rrëth marrëdhënieve hapësinore"



dhe në kohët moderne e deri tani (Varcárcel, 2000). Prandaj, konceptimi gjografik i cili, në krahasim me qasjen shkencore në hartografi ka një traditë të gjatë, mundet, së pari dhe më kryesorja, të japë koordinatat epistemologjike që kontekstualizojnë dhe veprojnë si një referencë për ndonjë përpjekje të trajtimit të hartografisë në nga një perspektivë shkencore dhe disiplinare.

Hartografia është shkenca që merret me paraqitjen dhe hetimin e fenomeneve natyrore dhe të shoqërisë me anë të imazheve gjografike dhe imazheve të tjera hartografike. Nisur nga ky përkufizim, arrihet në përfundimin se hartografia është një shkencë e ndërlikuar dhe përfshin disa disciplina.

Hartografia është arti, shkenca dhe teknologjia e bërjes së hartave, së bashku me studimin e tyre si dokumente shkencore dhe vepra arti. Në këtë kontekst, ne mund të konsiderojmë të gjitha llojet e hartave duke përfshirë të gjitha planet, profilet, dhe seksionet, modelet tre-përmasore dhe globet që përfaqësojnë tokën ose ndonjë trup qiellor në çdo shkallë (*International Cartographic Association 1973*).

Shoqata Ndërkombëtare Hartografike e përcakton hartografinë si "arti, shkenca dhe teknologjia e krijimit të hartave, së bashku me studimin e tyre si dokumente shkencore dhe vepra arti. Në këtë kontekst mund të konsiderohet se përfshihen të gjitha llojet e hartave, planet, planimetritë, dhe seksionet, modelet tripërmasore dhe globet që përfaqësojnë Tokën ose ndonjë trup qiellor në çdo shkallë". Ky përkufizim mund të aplikohet me sukses në hartografinë dixhitale dhe kompjuterike, vetëm se fjalë "studim" ka kuptim më të thellë: harta multimediale ka thellësinë ose aftësinë për të ndryshuar pamjen vizuale dhe mundësinë për të kërkuar për informacion të ri nga bazat e të dhënave të lidhura.

Lidhur me marrëdhëniet midis hartografisë dhe shkencave të tjera, Ogrissek (1987) i konsideron gjografinë dhe gjeodezinë si disciplina mëmë të hartografisë dhe thekson se këto marrëdhënie janë gjenetike ç'ka i justifikon ato si shkenca mëmë të hartografisë.

Në hartografinë teorike janë zhvilluar modele për të treguar lidhjet ndërmjet hartografisë dhe disiplinave të tjera. Për shembull, Ogrissek (1987) në modelin e tij strukturor të hartografisë teorike, tregon relacionin ekzistues ndërmjet teorisë së përgjithshme të organizimit të hartës dhe teorisë së përgjithshme të përdorimit të hartës. Ky model tregon një seri lidhjesh që e kanë origjinën ndërmjet shkencave të tjera të ndryshme dhe disiplinave e temave ose subjekteve të hartografisë që u përkasin të dy teorive të lartpërmendura.

Nga ana tjetër, në lidhje me pozitën e hartografisë teorike në skemën bazë të hartografisë, Koch (1995) e vendos atë nën ombrellën e hartografisë si një shkencë, përveç hartografisë empirike dhe "Metodave hartografike" dhe e vë



atë në kontrast me hartografinë e Aplikuar. Në këtë skemë autor i gjithashtu trajton marrëdhëniet midis hartografisë teorike dhe komponentëve të tjera.

Hartografia, pavarësisht se shpesh konsiderohet një "shkencë e llojit të katërt"⁸, përdor drejtpërdrejt parimet dhe konceptet e shkencave të tipit të tretë, pra shkencave fizike / natyrore dhe postulatet e shkencave të tipit të parë, shkencave formale të tilla si matematika. Në anën tjetër, disiplinat gjeografike dhe hartografike zbulojnë një ndryshim të dukshëm në lidhje me zhvillimin e tyre teorik. Kur krahasojmë gjeografinë sasiore me fushën e projekksioneve hartografike shohim se, e para bën përdorimin vetëm të parimeve gjeometrike dhe topologjike në një mënyrë referenciale ose skematike. Megjithatë, parimet matematike (gjeometrike) janë pjesë thelbësore për projekzionet e hartës dhe për këtë arsy, shkojnë shumë më larg se një referencë e thjeshtë.

2.1. Hartografia si Komunikim

Një nga qasjet më të dobishme në studimin e hartografisë është përcaktimi i hartave si një formë e komunikimit vizual - një gjuhë e qëllimit të veçantë për pëershkrimin e marrëdhënieve hapësinore. Edhe pse ndoshta është e pamatëshme nxjerra e një analogjie të drejtpërdrejtë midis hartografisë dhe gjuhës, koncepte të tilla si "gramatikë" dhe "sintakse" ndihmojnë për të shpjeguar, të paktën në mënyrë metaforike, llojet e vendimeve që hartografët duhet të marrin pasi ata kompozojnë hartën. Hartografët përdorin burime vizuale të tilla si ngjyra, forma dhe modele për të komunikuar informacionin në lidhje me marrëdhëni hapësinore. Analogjia me gjuhën gjithashtu ndihmon në shpjegimin pse trajnimi në parimet e hartografisë efektive është aq e rëndësishme - ajo lejon komunikimin në mënyrë më efikase. Pa njojuri në disa nga këto parime themelore, hartografi fillestar ka të ngjarë të keqkuptohet ose të shkaktojë konfuzion.

- ✓ *Hartografia është e lidhur ngushtë me komunikimin grafik*

Hartografia është e lidhur me komunikimin grafik, por ndryshon nga format e tjera të komunikimit vizual. Hartografët duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë sistemeve të koordinatave, projekssioneve hartografike dhe çështjeve të shkallës dhe drejtimit që janë në shumicën e rasteve relativisht me pak interes për dizajnitë e tjerë grafik ose artistët. Por, për shkak se hartografia

⁸ Lloji i parë i shkencave: shkencat formale - logjike e matematike; lloji i dytë: gjeodezia – shkencë mëmë e hartografi; lloji i tretë: shkencat humane; lloji i katërt: hartografia; lloji i pestë: shkencat natyrore/gjeoshkencat plus shkencat sociale; lloji i gjashtë: shkencat bazë si: fizika, kimia etj.



është një lloj i komunikimit grafik, disa njohuri mbi kërkesat e hartografisë mund të nxirren nga literatura e komunikimit grafik dhe grafika statistikore. Shpesh hartografët ballafaqohen me disa prej sfidave që hasen nga designers grafike dhe mund të mësojnë shumë nga njohuritë e tyre.

- ✓ *Hartat janë abstraksione simbolike - "përgjithësime" ose "përfaqësime" - të realitetit*

Duke e vënë theksin në hartografinë si një formë komunikimi, është më e lehtë të mendojmë se hartat janë me të vërtetë abstraksione simbolike - ose përfaqësime - të fenomeneve të botës reale. Në shumicën e rasteve, kjo do të thotë se bota e përfaqësuar në një harrë thjeshtohet në masë të madhe, ose përgjithësitet, me simbole që përdoren si fjalë që qëndrojnë për objektet e vërteta. Disa nga vendimet më të rëndësishme që hartografët marrin në procesin e projektimit hartografik sillen rreth: 1) se sa thjeshtohet/lehtësitet situata duke e përshkruar atë, dhe 2) se si simbolizohen marrëdhëniet që përfaqësohen

3. PËRFUNDIME

- Zhvillimi dhe konsolidimi i hartografisë teorike ka rëndësi të veçantë sepse ndikon seriozisht në cilësinë e pwrftimit tw materialeve hartografike, uljen e kostos dhe rritjen e sasisë së tyre. Ky përfundim është me vlerë, sidomos sot, kur harta dhe materiale të tjera hartografike janë produkte të Sistemeve tw Informacionit Gjeografik (GIS).
- Aktualisht, konceptet për hartwn dhe hartografinw janë të ndryshme. Autorët e kwtij punimi nuk e mbështesin konceptin informativ tw hartës të ofruar nga shumë autorë të huaj, pasi ky është një koncept mjaft e ngushtë, që nuk përfshin kërkesat e një game të gjërë pwrdoruesish.
- Hartografia duhet të konsiderohet si një disiplinë shkencore, që nga përbajtja është e përqendruar kryesisht në aspektin shkencor tw hartografimit, ndërsa ana artistike e saj duhet tw shtrihet deri në atw masw sa ta bwjw hartwn më të lexueshme. Arti ka nevojë për shkencën dhe teknikwn për ndërtimin e veprave të artit.



LITERATURA

1. Andrews, J.H. 1996: "What Was a *Map*?" The lexicographer reply. *Cartographica* 33:4, fq. 1-11
2. Cartwright, W., 2008. Art and Cartographic Communication. In: Cartwright, W., Gartner, G. & Lehn, A. eds., 2008. *Cartography and Art*. Berlin Heidelberg: Springer-Verlag.
3. <http://www.maphistory.info>
4. International Cartographic Association, 1973. *ICA News* 13. Aberdeen, UK.
5. International Cartographic Association, 1984. *Basic Cartography for Students and technicians*, Vol. 1 third edition.
6. International Cartographic Association, 1996. *ICA News* 26. Aberdeen, UK.
7. Koch, W.G., 1995. Concepts for the Teaching of Theoretical Cartography. In: Institut Cartogràfic de Catalunya (Ed.). *Cartography Crossing Borders*. 7th International Cartographic Conference, Proceedings 2, Barcelona 1995.
8. Koch, W.G., 2002. Cartographic Theories. In: A. Wolodtschenko, ed. 2003. *The Selected Problems of Theoretical Cartography*. Institute for Cartography, Dresden University of Technology, Dresden, Germany.
9. Michael Wood 'Whither maps and map design', *Bulletin of the Society of Cartographers*, XXVII (1993), fq. 8".
10. Montello, D. R. (2002) Cognitive map-design research in the twentieth century: Theoretical and empirical approaches. *Cartography and Geographic Information Science*, 29, p283-304.
11. Ogrissek, R., 1987. *Theoretische Kartographie*. VEB Hermann Haack, Geographish Kartographische Anstalt, Gotha.
12. R.J. Johnston, Derek Gregory and David M. Smith, *The dictionary of human geography* (3rd edition, Oxford, 1994).
13. Sluter, R. Jr., 2001. New Theoretical Research Trends in Cartography. *Revista Brasileira de Cartografia*, (53).
14. UN Documents, I, 19, p. 8
15. Valcárcel, J.O., 2000. *Los Horizontes de la Geografía. Teoría de la Geografía*. Barcelona: Ariel Geografía ediciones.



ROLI I ARSIMIT NË GJEO SHKENCA PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË SË DIJES SI KUSHT PËR ZHVILLIMIN E MIRËQENIES SHOQËRORE

(The role of education in geo fields for creating a knowledge society as a condition for the social welfare development)

Metush SULEJMANI¹, and Zija ZIMERI²

SUMMARY

Education in the contemporary society, a society that is increasingly becoming an information and knowledge society, has the quality of one of the most important factors of social development and an extremely important resource for economic, political, cultural and technological development of any country. Education, being one of the most important sources of development, is producing relevant knowledge and values which play a vital role not only for the advancement of the civilizations in general, but for the progress of the development of any particular individual as well. World civilization is facing and experiencing rapid and profound social changes. These changes, on local, regional and global level, are related to the increasing knowledge that is a product of education and training, which accelerate the social development. Therefore, education and training are a social process of acquisition of knowledge and, therefore, are of great importance for the advancement of modern society and the emergence of social welfare, which contribute to the equilibrium of the social processes and the advancement of democratic values. In general, development, as a component that comprises social and educational contents, represents the essence of the social changes which are related to the economic, social, political and cultural welfare. The power of the educational values is that it enables the transformation of the traditional systems to contemporary ones. A learned society, which is fruit of educational values, has the potential and capacity to create a social welfare that inevitably leads to the changing of attitudes, value system, and the lifestyle of people and social groups. Education, as the fundamant of modern civilizations, is a key factor of the economic development of any society by changing human life individually and collectively, thus contributing to raising the standard values and their social life. Educational values are a source of social advancement and, in sociological terms, they represent a social process through which new generations acquire knowledge and new values that are of exceptional importance for social changes and the civilizing process.

¹ Assoc.Prof.Dr. Metush SULEJMANI, metush.sulejmani@unite.edu.mk
State University of Tetova, www.unite.edu.mk

² Ass.Prof.Dr. Zija ZIMERI, zija.zimeri@unite.edu.mk, zija.zimeri@hotmail.com
State University of Tetova; Faculty of Natural and Mathematical Sciences.
Cel: +389 70 398600, www.unite.edu.mk



Key words: education, educational values, knowledge society, social changes, social welfare, civilization

ABSTRAKT

Arsimi në shoqërinë bashkëkohore, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet shoqëri informative dhe e dijes,është në cilësinë e një nga faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit shoqëror dhe një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, politik, kulturor dhe teknologjik të çdo vendi. Arsimi si njëri nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit, po prodhon njoħuri dhe vlera relevante të cilat luajnë një rol jetik ekzistencial jo vetëm për përparimin e qytetërimit dhe civilizimit në përgjithësi, por edhe për ecurinë e zhvillimit të çdo individi në veçanti. Civilizimi botëror po përballet dhe po përjeton ndryshime të shpejta dhe të thella shoqërore. Ky ndryshim në nivel lokal, regional dhe planetar ndërlidhet me rritjen e njoħurive të cilat janë produkt i arsimit dhe edukimit të cilat e përshpejtojnë zhvillimin social. Prandaj, arsimi dhe edukimi janë një proces social i përvetësimit të njoħurive të cilat padyshim që kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore dhe krijimin e mirëqenies sociale të cilat kontribuojnë për ekuilibrimin e proceseve shoqërore dhe avancimin e vlerave demokratike. Në përgjithësi zhvillimi si një komponentë me përbajtje socio-arsimore dhe edukative paraqet esencën e ndryshimeve shoqërore të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike, sociale, politike, kulturore etj. Forca e përbajtjes së vlerave edukativo-arsimore qëndron aty që ajo bënë transformimin e sistemeve tradicionale në ato bashkëkohore. Shoqëria e dijes e cila është rezultat i vlerave arsimore ka potencial dhe kapacitet për krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila në mënyrë të pashmangshme çon në ndryshimin e qëndrimeve, sistemin e vlerave, stilin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve dhe grupeve shoqërore. Arsimi, si bazë e qytetërimit bashkëkohor,është faktori kyç i zhvillimit ekonomik të çdo shoqërie duke e ndryshuar jetën e njeriut si në aspektin individual ashtu edhe grupor duke kontribuar në ngritjen e vlerave dhe të standardit të jetës së tyre shoqërore. Vlerat arsimore si burim i zhvillimit shoqëror, në aspektin sociologjik paraqesin procesin social përmes së cilit gjeneratat e reja fitojnë njoħuri dhe vlera të reja të cilat janë të një rëndësie të veçantë për ndryshime shoqërore civilizuese.

Fjalët kyçe: arsimi, vlerat edukativo-arsimore, shoqëria e dijes, ndryshimet shoqërore, mirëqenia shoqërore, civilizimi.



1. HYRJE

Arsimi në shoqërinë bashkëkohore, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet shoqëri informative, e dijes dhe e zhvilluar, është në cilësinë e një nga faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit shoqëror dhe një burim jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillimin e sajë ekonomik, politik, kulturor dhe teknologjik. Arsimi si njëri nga burimet më të rëndësishme të zhvillimit, po prodhon njoħuri dhe vlera relevante kognitive të cilat luajnë një rol jetik ekzistencial jo vetëm pér pérparimin e qytetërimit dhe civilizimit në përgjithësi, por edhe pér securinë e zhvillimit të çdo individi në veçanti. Civilizimi botëror po pérballat dhe po pérjeton ndryshime të shpejta dhe të thella shoqërore. Ky ndryshim në nivel lokal, regional dhe planetar ndërlidhet me rritjen e njoħurive të cilat janë produkt i arsimit dhe edukimit të cilat e pérshpejtojnë zhvillimin social. Prandaj, arsimi dhe edukimi janë një proces social i përvetësimit të njoħurive të cilat padyshim që kanë rëndësi të madhe pér zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore dhe krijimin e mirëqenies sociale të cilat kontribuojnë pér ekuilibrimin e proceseve shoqërore dhe avancimin e vlerave demokratike. Në përgjithësi zhvillimi si një komponentë me pérmbajtje socio-arsimore dhe edukative paraqet esencën e ndryshimeve shoqërore të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien ekonomike, sociale, politike, kulturore etj. Forca e pérmbajtjes së vlerave edukativ-arsimore qëndron aty që ajo bënë transformimin e sistemeve tradicionale në ato bashkëkohore. Shoqëria e dijes e cila është rezultat i vlerave arsimore ka potencial dhe kapacitet pér krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila në mënyrë të pashmangshme çon në ndryshimin e qëndrimeve, sistemin e vlerave, stilin dhe mënyrën e jetesës së njerëzve dhe grupeve shoqërore. Arsimi, si bazë e qytetërimit bashkëkohor, është faktori kyç i zhvillimit ekonomik të çdo shoqërie duke e ndryshuar jetën e njeriut si në aspektin individual ashtu edhe grupor duke kontribuar në ngritjen e vlerave dhe të standardit të jetës së tyre shoqërore. Vlerat arsimore si burim i zhvillimit shoqëror, në aspektin sociologjik paraqesin procesin social përmes së cilit gjeneratat e reja fitojnë njoħuri dhe vlera të reja të cilat janë të një rëndësie të veçantë pér ndryshime shoqërore civilizuese.

2. ARSIMI NXITËS I NDRYSHIMEVE SHOQËRORE

Shoqëria njerëzore, e çfarëdo tipi qoftë e veçanërisht ajo bashkëkohore ka nevojë permanente pér ndryshim dhe zhvillim. Ndryshimi është ajo që e mbanë dhe e zhvillon shoqërinë dhe se proceset shoqërore të cilat karakterizohen me ndryshime, janë mënyra e plotësimit të nevojave



njerëzore. Ndryshimi si kategori sociologjike është me përbajtje shumëdimensionale çka do të thotë që aty ndikojnë një mori faktorësh në mesin e të cilave vend qendror ka arsimimi dhe edukimi. Nuk ka shoqëri të përparuar, të emancipuar dhe të civilizuar pa një arsimim të mirëfilltë dhe me vlera të caktuara. Njeriu është ai i cili me aktivitetin e tij proceseve shoqërore iu jep përbajtje, i projekton dhe i orienton në dimensionin e kohës dhe hapësirës. Mirëpo ky njeri për të iniciuar ndryshimet dhe përtu bërë pjesë e ndryshimeve duhet të jetë i arsimuar i edukuar dhe socializuar. Civilizimi bashkëkohor kërkon njerëz të aftë, të ditur dhe me vizion për të qenë bartës të progresit shoqëror. Nga kjo mund të thuhet se arsimi është bartës dhe nxitës i progresit shoqëror, ekonomik, politik dhe kulturor i njerëzimit. Procesi arsimor dhe institucionet arsimore përfshirë këtu të gjitha llojet e shkollave deri te ai universitar, njeriun dhe shoqërinë e pajisin me dituri dhe shkathësi duke i aftësuar për krijimin dhe zbatimin e teknologjive të reja në procesin e prodhimit. Arsimi është një nga faktorët më strategjik të shoqërisë i cili nxitë zhvillimin shkencor-teknologjik i cili më vonë do të nxisë ndryshime të thella në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Pra vetë sistemi arsimor është pasqyra reale e një shoqërie përmes së cilës pasqyrohet niveli i zhvillimit global të një shoqërie. Vetëm njerëzit e arsimuar janë ata që i lëvizin përpëra proceset shoqërore. Në literaturën sociologjike shpeshherë potencoherë dhe analizohen dy teza:

1. Arsimi është funksion i shoqërisë dhe
2. Shoqëria është funksioni i arsimit dhe shkollës (Shehu Shaban "Sociologjia e arsimit", 2001, faq. 101, Shkup)

Sa i përket tezës së parë mundë të thuhet që bëhet fjalë për shoqëritë më pak të zhvilluara dhe të demokratizuara ku sistemi arsimor dirigjohet nga qendra të ndryshme të politikës shtetërore duke ia uzurpuar autonominë e tij.

Kurse pikëpamja e dytë niset nga fakti që e tërë shoqëria është funksion i sistemit arsimor dhe i cili ndërlidhet me kushtet e zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore ku përmes së cilës realizohen dituria, socializimi, aftësimi profesional etj. Paradigmat teorikë metodologjike nga sociologjia e arsimit kanë dëshmuar që përbajtja e sistemit arsimor është në lidhshmëri të ngushtë me karakterin e organizimit dhe të zhvillimit të shoqërisë. Arsimi çdoherë ka qenë në cilësinë e një promotori të zhvillimit të vlerave shoqërore dhe atyre kulturore dhe shkencore të cilat kanë qenë dhe janë në shërbim të plotësimit të kërkesave dhe nevojave njerëzore. Arsimi si nxitës i ndryshimeve shoqërore te njeriu së pari ndikon për ngritjen e vetëdijes së tij mbi vetveten dhe shoqërinë që më pastaj të jetë i aftë ti artikuloj kërkesat dhe nevojat e tyre drejtë një ardhmërie më të mirë. Zhvillimi i bazuar në dituri qoftë në nivelin individual apo grupor-shoqëror është i konceptuar sipas modelit të kapitalit intelektual i cili është rezultat i vlerave të mirëfillta arsimore. Nëse merren parasysh dhe analizohen funksionet e sistemit



arsimor siç janë ato manifeste dhe latente e veçanërisht funksioni i krijimit të diturive të reja –inovative dhe socializimit do të konstatojmë që sistemi arsimor në tërësi e veçanërisht ai sipërор ndikon në krijimin e vlerave inovative. Këto vlera inovative që janë produkt i kapitalit intelektual njerëzor dhe që burojnë nga vlerat arsimore janë mekanizmi kryesor i ndryshimeve shoqërore të cilat sdo mend që kontribuojnë për përparimin e shoqërisë dhe krijimin e një mirëqenie shoqërore e cila ndikon në përmirësimin e kushteve jetësore dhe ngritjen e standardit ekonomik të njerëzve. Esenca e të gjitha ndryshimeve shoqërore qëndron në vlerat inovative dhe zbulimet shkencore të cilat e kanë revolucionuar shoqërinë njerëzore. Vlerave inovative në një shoqëri iu paraprinë ideja apo dituritë, njojuritë dhe shkathësitë kognitive të cilat janë rezultat i procesit arsimor institucional. Vetë ideja si paraprirës e vlerave inovative ka kapacitet për ndryshime progresive në shoqëri. Ndryshimet dhe produktiviteti shoqëror janë produkt i inovacioneve tekniko-teknologjike të cilat janë në shërbim të përmirësimit të pozitës ekonomike të popullatës. Inovacioni teknologjik është rruga më e sigurt për rritjen e produktivitetit dhe zgjidhjen e problemit të zhvillimit (Dr.Dragutin,J.Boshkoviq “Tehnoloshke inovacije i produktivnost” Rad,Beograd,Faq.8.1976).

Sistemi arsimor në kuptimin shoqëror dhe historik është proces dhe aktivitet edukativo-arsimor institucional. Ky lloj arsimimi i cili është pjesë përbërëse e shoqërisë dhe pjesë e nevojave shoqërore zhvillohet në tre drejtime kryesore:

1. Bënë zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të individit,
2. E afteson njeriun për ushtrimin e rolit të tijë në shoqëri
3. I zhvillon dhe avancon vlerat kulturore në shoqëri.

Sistemi arsimor si vlerë dhe resurs shoqëror ka më shumë komponentë dhe elemente si p.sh: ai është si institucion, si proces dhe veprintari organizative. Duke e pasur parasysh këtë përbajtje të vlerave arsimore mund të thuhet që arsimi është proces sociologjiku-pedagogjik i paramenduar i organizuar dhe i institucionalizuar, gjegjësisht përvojë e individit e cila ka të bëj me ngritjen e njojurive dhe shkathtësive për zhvillimin e aftësive të tijë.(Jeloviq.F.1994,”Didakticke osnove nastave” faq.10,Jastrebarsko Naklada).

Sipas Glaserit, arsimi është avancimi dhe zbatimi i njojurive, kurse sipas Rebilit, arsimi është tërësia e procedurave dhe proceseve të cilat çdo fëmije i mundësojnë qasje në kulturë.(Miolaret,G.1989.”Uvod u edukacijske znanosti”, Zagreb).

Botën bashkëkohore e karakterizojnë ndryshime të mëdha të cilat arsimin e karakterizojnë si mekanizëm apo instrument i zhvillimit shoqëror. Bota bashkëkohore ka nevojë për një arsimim progresiv i cili evoluon përmes individit, shkencës dhe shoqërisë. Shoqëria bashkëkohore e industrializuar



dallohet me një arsimim masiv dhe gjithëpërfshirës i cili mundëson ngritjen profesionale të fuqisë punëtore dhe atë përmes arsimimit profesional.

Në krahasim me arsimin e shoqërive statike i cili është pasiv ku edhe individi shndërrohet në qenie pasive, arsimimi i shoqërisë bashkëkohore industriale karakterizohet me një përmbajtje dinamike i cili ka kapacitet për reforma dhe ndryshime të thella shoqërore. Shoqëria bashkëkohore karakterizohet me një zhvillim të hovshëm dhe dinamik por me plot kontradikta dhe konflikte të natyrave të ndryshme prandaj një arsimim me vlera të mirëfillta është i nevojshëm për avancimin e proceseve shoqërore. Duke marrë parasysh karakterin kontradiktorë të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore do të vijmë në dilemën: a duhet që arsimi të përshtatet në ndryshimet aktuale shoqërore apo duhet të kemi një sistem arsimor i cili duhet të inicioj ndryshime? Nëse i marrim parasysh ndryshimet shoqërore dhe kahjen e zhvillimit të procesit arsimor në pjesën e Evropës Jug-Lindore mundë të themi që sistemi arsimor ka kaluar përmes dy periudhave:

1. Tranzicioni shoqëror dhe
2. Aspekti reformues i arsimit.

Periudha e parë e sistemit arsimor që ndërlidhet me periudhën transitore e cila akoma vazhdon, karakterizohet me atë që arsimi është funksioni i shoqërisë dhe duhet që të i përgjigjet ndryshimeve shoqërore në tërësi. Në shumë vende të Evropës jug-Lindore ka pasur një disproporcional mes ndryshimeve shoqërore dhe vetë përmbajtjes dhe karakterit të sistemit arsimor. Me fjalë tjera, arsimi një kohë ka funksionuar sipas vlerave të sistemit të kaluar monist ku ndryshimet kanë qenë sipërfaqësore dhe nuk është vepruar në drejtim të krijimit dhe avancimit të vlerave të mirëfillta edukativo-arsimore veçanërisht në tekstet shkollore të shkencave shoqërore. Prandaj në disa vende siç është Maqedonia ky disproporcional mes sistemit arsimor dhe ndryshimeve shoqërore nxiti konflikte tensione dhe konflikte ndëretnike. Filozofi gjerman immanuel Kanti në lidhje me sistemin arsimor dhe autorët e programeve arsimore thoshte që krijuesit e programeve arsimore çdo herë duhet ta kenë parasysh parimin në vijim: botëkuptimi i fëmijës nuk duhet të orientohet kah gjendja aktuale e njerëzimit por më tepër kah ardhmëria e tyre, gjegjësisht kah ajo gjendje e projektuar e cila i përshtatet idesë, qëllimi final i së cilës është humaniteti. (Sulejmani.M. 2012. "Procesi edukativo-arsimor dhe marrëdhëni ndëretnike në Republikën e Maqedonisë", faq. 115, Furkan, Shkup).

Periudha e dytë e arsimit karakterizohet me tendencat reformuese të sajë kurë sistemi arsimor përveç që i harmonizon vlerat e sajë arsimore me ndryshimet shoqërore, ai merr hapa të mëtutjeshëm për reforma dhe ndryshime shoqërore të cilat janë kërkesa dhe nevojë e trendëve bashkëkohore. Ky lloj sistemi arsimor që të funksionoj me sukses dhe të jetë kreativ, është e nevojshme që të lirohet nga të gjitha shtrëngesa ideologjike



me qëllim që të inicioj vetëdije kritike dhe vlera të shëndosha shkencore, humane dhe demokratike si kusht për integrim në kulturën dhe civilizimin evropian dhe botëror. Pra sistemi arsimor nuk guxon të jetë vetëm kopje e shoqërisë por një instrument përmes së cilit duhet të realizohen mbajtja apo ruajtja e ekzistencës shoqërisë, edukimi dhe socializimi pozitiv përparimtarë të rinjve. Vlerat arsimore që burojnë nga tekstet shkollore dhe kurrikulumi, janë promotorë të tendencave zhvillimore në të gjitha fushat e jetës, këto vlera arsimore përveç që tregojnë gjendjen faktike të shoqërisë ato edhe bëjnë projektimin për zhvillimin dhe ndryshimin e ardhshëm të shoqërisë. Pra këto vlera arsimore si burim i njohurive, shkathtësive dhe socializimit të rinjve të cilat njëherë kanë edhe përmbajtje inovative, paraqesin një lloj dokumenti programor i cili do të shërbej për orientimin, dinamizimin dhe avancimin e proceseve shoqërore.

3. VLERAT ARSIMORE INOVATIVE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË

Vlerat arsimore të mirëfillta, të cilat janë produkt të sistemit arsimor formal dhe institucional, në brendinë e tyre hasim përmbajtje inovative shkencore të cilat padyshim që janë në funksion të zhvillimit të shoqërisë dhe krijimit të mirëqenies shoqërore. Kjo mirëqenie shoqërore me komponentat e saja ekonomike, sociale, politike dhe kulturore është në funksion të plotësimit të dinjitetshëm të nevojave njerëzore e cila ndikon jo vetëm për një jetë dinjitoze por edhe për një harmoni, stabilitet dhe funksionalitet të proceseve shoqërore. Kjo formë e arsimimit nga i cili del funksionaliteti i shoqërisë, është dhe çdoherë do të jetë në shërbim të iniciimit të reformave shoqërore të cilat kanë të bëjnë edhe me ndryshimet shoqërore por edhe me ruajtjen e shoqërisë. Këto vlera arsimore që iniciojnë dhe krijojnë mirëqenie shoqërore, gjeneratën e re e përgatisin që të adaptohen në shoqëri, të adaptohen në ndryshimet shoqërore dhe në fund të dinë që të nxisin ndryshime që nga mjedisi lokal ku jetojnë e deri te niveli qendror i hierarkisë së shoqërisë. Vlera arsimore inovative nuk mund të krijoj çdo sistem arsimor por vetëm ai i cili zhvillohet në kushte demokratike, që ka pavarësinë e tij dhe i cili vepron dhe funksionon jashtë ndikimeve ideologjike gjegjësisht kurë zhvishen interesat individuale dhe në shprehje vijnë ato të përgjithshmet të cilat janë në shërbim të mbrojtjes së vullnetit të qytetarëve. Pra dituria shndërrohet në resurs dhe kapil intelektual e cila inicijon ndryshime shoqërore të cilat kurorëzohen me mirëqenie shoqërore. Në shoqërinë e dijes në qendër të vëmendjes është njeriu i arsimuar dhe emancipuar i cili mundë të jetë jo vetëm projektues por edhe iniciues i proceseve shoqërore. Perspektiva dhe ardhmëria e çdo shoqërie varet nga niveli dhe kapaciteti i



dijes apo të të menduarit kreativ që del nga sistemi arsimor. Arsimi është njëri nga elementet e strategjisë shkencore i cili vihet në shërbim të zhvillimit të ardhshëm të shoqërisë duke e avancuar dhe përforcuar prodhimtarinë ekonomike. Investimi më rentabil i një vendi është investimi në arsim i cili më vonë do të nxisë prodhimtarinë e ndërmarrjeve ekonomike e cila ndikon në ngritjen e standardit jetësor të popullatës. Arsimi dhe shkenca duke u bazuar në vlerat inovative të tyre, janë një nga ato instrumentet themelore për zhvillimin ekonomik të vendit të cilat garantojnë një ardhmëri më të sigurt. Shoqëria bashkëkohore karakterizohet me ndryshime të thella dhe të shpejta ku sistemi arsimor ka një rol jashtëzakonisht të madh funksional në menaxhimin e proceseve shoqërore septe: -jeta shoqërore me të gjitha komponentët po bëhet gjithnjë e më komplekse, natyra dhe mënyra e prodhimitarisë po ndryshon me dinamikë të madhe, koha në të cilën qienëson shoqëria njerëzore është e paparashikueshme, e kaluara dhe karakteri tradicional i sajë, duke marrë parasysh edhe aspektin tekniko-teknologjike të sajë, gjithnjë e më tepër po e humbë mbështetjen për avancimin e proceseve shoqërore. Proceset shoqërore bashkëkohore kërkojnë sistem të atillë arsimor i cili do të ecë paralelisht me ndryshimet shoqërore. Shoqëritë në të cilat vlerësohen vlerat arsimore si resurs dhe kapital intelektual, të cilat kanë të zhvilluar sistemin informativ dhe ku vlerësohen kreativiteti dhe aftësitë individuale mundë ti quajmë shoqëri inovative. Shumë shtete të zhvilluara ekonomikisht (Japonia, SHBA-të etj.) shumë më herët kanë sjellë vendime strategjike që ekonomitë e tyre të ndryshojnë strategjinë e zhvillimit. Këto vende në vende që të investojnë në industrinë e rëndë ato kanë investuar në veprimtarinë e cila bazohet në mendjen- trurin dhe diturinë njerëzore rezultatet e të cilave po vërehen tani. Ekonomitë e shteteve bashkëkohore kanë nevojë strategjike për intervenim të kuadrove profesioniste të cilat do të bëjnë zbatimin e këtyre të arriturave tekniko-teknologjike.

4. NDRYSHIMET SHOQËRORE DHE ARDHMËRIA

Shumë shkencëtarë duke i hulumtuar ndryshimet shoqërore kanë pyetur se kah çojnë këto ndryshime, cila është perspektiva e tyre dhe cilat janë pasojat e tyre. Shumë mendimtarë që ishin hulumtues të proceseve shoqërore të shekullit 20 ishin të mendimit që era e re do të jetë një shoqëri e re që nuk do të bazohet te industrializmi por përtej vlerave të kësaj shoqërie. Për ta pëershruar rendin e ri shoqëror janë sajuar një sërë termash si shoqëria e informacionit, shoqëria e shërbimit ose shoqëria e dijes. Disa autor kanë folur për shoqërinë pasmoderne ose të pas krizës. Megjithatë, termi më i përmendur është shoqëri pasindustriale, i përdorur për herë të parë nga



Daniel Bell në Shtetet e Bashkuara dhe Alen Turen në Francë. (Antoni Gidens “Sociologjia”2007, faq.616,Tiranë).Shkencëtari japonez Ito në vitin 1981 e plasoi termin shoqëri informative. Shoqëria informative si shoqëri e dijes sipas shkencëtarëve Çarls Stainfeld dhe Xheri Salvaxhio karakterizohet me këto karakteristika. 1. Aspekti struktural ekonomik, 2. Aspekti konsumues, 3. Aspekti kritik dhe 4. Aspekti multidimensional. (Mihael Kunçuk Astrid Cipfel,1998, “Voved vo naukata za publicistika i komunikacii”,faq.34,Fondacioni “Fridrih Ebert,Shkup). Epoka informative si shoqëri postindustriale apo postmoderniste, e cila bazohet në vlerat arsimore dhe përbajtjen e tyre inovative, i jep formë dhe kuptim të gjitha proceseve shoqërore si në aspektin lokal, kombëtarë apo ndërkombëtarë sepse këto rezultate të sistemit arsimor nuk kanë kufijtë nacional dhe janë në shërbim të mbarë civilizimit. Kjo shoqëri karakterizohet jo me rrugëtimin drejtë asaj që është masive apo globale makrosociologjike por drejtë asaj që është e veçantë,specifike apo mikrosociologjike. Si rezultat i dijes dhe vlerave informative në këtë shoqëri paraqitet nevoja për specializime më të detajuara ku vjen në shprehja dija e kodifikuar e cila është burim strategjik nga e cila varet vet shoqëria. Ata që janë të interesuar për krijimin dhe shpërndarjen e sajë-shkencëtarët, informacionët, ekonomistët, inxhinierët dhe specialistët e të gjitha llojeve-bëhen gjithnjë e më shumë grupet sociale drejtuese që zëvendësojnë industrialistët dhe sipërmarrësit e sistemit të vjetër. (Gidens.A.faq.620).Kjo shoqëri bashkëkohore themellet e së cilës mbështeten në vlerat e mirëfillta arsimore apo komponentët tekniko-teknologjike të sajë është në shërbim të krijimit të një mirëqenie shoqërore ku njerëzit më lehtë do ti plotësojnë nevojat e tyre, do të kenë një standard më të avancuar ekonomik dhe do të janë qytetarë më të devotshëm në bashkësinë socio-politike ku jetojnë.

5. REZYME

Arsimi si kapital intelektual ka rëndësi tepër të madhe si për individin ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Vlerat arsimore të mirëfillta janë ato të cilat ndikojnë në ndryshimin dhe zhvillimin e shoqërisë si dhe avancimin e proceseve shoqërore të një shoqërie. Asnjë shoqëri njerëzore nuk ka mundur që të zhvillohet, të përparoj dhe të garoj me shoqëritë tjera të civilizuara pa një arsim adekuat. Arsimi dhe edukimi i një shoqërie është bazamenti kryesor i zhvillimit të gjithëmbashëm të shoqërisë mbi bazën e së cilët mbështetet progresi shoqëror në kuadër të të cilit paraqitet mirëqenia shoqërore e cila mund të jetë e karakterit ekonomik, politik, social, kulturor etj. Pikërisht vlerat arsimore relevante dhe kualitative janë ato që i dinamizojnë proceset shoqërore në drejtim të plotësimit të nevojave dhe



kërkесаве нjerëзоре. Veçanërisht funksioni inovativ i arsimit ёштë ai i cili ka të bëj me zbulimet shkencore të cilat do të jenë në shërbim jo vetëm të një shoqërie por për mbarë njerëzimin. Këto vlera inovative të arsimit mundësojnë zhvillimin tekniko-teknologjike të një shoqërie e cila mundëson rritjen e kapaciteteve ekonomike dhe të mirave materiale përmes të cilave reduktohet varfëria dhe papunësia dhe rritet mirëqenia shoqërore. Këto shoqëri të cilat bazohen në këto vlera arsimore janë shoqëri të dijes dhe informacionit të cilat janë pjesë përbërëse të shoqërive bashkëkohore demokratike. Shoqëritë e këtilla me këto vlera arsimore të cilat mund ti llogarisim si shoqëri të mirëqenies shoqërore, karakterizohen me vlera të larta civilizuese dhe demokratike në të cilat gjejnë zbatim adekuat të drejtat dhe liritë elementare të njerëzve si dhe funksionim efikas të shoqërisë civile.

LITERATURA

1. Shehu Shaban “Sociologjia e arsimit”, 2001, Shkup
2. (Dr. Boshkoviq J. Dragutin, 1976, “Tehnoloshke inovacije i produktivnost” Rad, Beograd
3. Jeloviq. F. 1994, ”Didakticke osnove nastave” Jastrebarsko Naklada Slap
4. Miolaret, G. 1989. ”Uvod u edukacijske znanosti”, Zagreb
5. Sulejmani. M. 2012. ”Procesi edukativo-arsimor dhe mardhëniet ndëretnike në Republikën e Maqedonisë”, Furkan, Shkup
6. Antoni Gidens “Sociologjia” 2007, Tiranë
7. Kunçuk. M, Cipfel, A. 1998, “Voved vo naukata za publicistika i komunikacii”, Fondacioni “Fridrik Ebert, Shkup).



KRIJIMI I MODELIT DIXHITAL TË TERRENIT NË CIVIL 3D NË FUNKSION TË NJEHSIMIT TË VËLLIMIT PËR DEPONINË E KELMENDIT

(Developing of Digital Terrain Model in Civil 3D for calculating the volumes for the Kelmend Landfill)

**Edon MALIQI¹, Edmond HAJRIZI²,
Gani MALIQI³, Abdurrahman KULETA⁴**

ABSTRAKT

Republika e Kosovës është një vend i njojur për pasuri nëntokësore. Krahas eksplotatimit të mineraleve, rëndësi të madhe ka edhe menaxhimi i mbeturinave minerare të cilat mbesin si rezultat i përpunimit të mineraleve. Vendet ku bëhet grumbullimi i këtij material steril (shterpë) quhen deponi dhe në mesin e disa deponive të cilat gjenden në vendin tonë është edhe deponija e Kelmendit, një vend në afërsi të Mitrovicës (Maliqi, 2014).

Qëllimi i këtij punimi është krijimi dhe paraqitja e modelit dixhital të terrenit të deponisë së Kelmendit, duke shfrytëzuar mundësit që ofron softueri AutoCad Civil 3D. Paraqitura e Modelit Dixhital të Terrenit të deponisë së Kelmendit është realizuar me metodat TIN dhe GRID. Softueri në fjalë ka metodologji të pasur për krijimin e Modelit Dixhital të Terrenit (MDT).

Krijimi i MDT-së për deponinë e Kelmendit është realizuar në punimin e masterit të Edon Maliqit nën udhëheqjen e mentorit Prof.dr.Edmond Hajrizi dhe komendorit Prof.dr.Bashkim Idrizi në Universitetin për Biznesë dhe Teknologji në Prishtinë (www.ubt-uni.net). Ndërsa qëllimet parësore të punimit është menaxhimi me efikas i deponisë dhe impact pozitiv në punën menaxhmentit të minierës së Trepçës në aktivitet e caktuara në deponi nëpërmjet krijimit të Modelit Dixhital të Terrenit (MDT) (Maliqi, 2014).

Fjalët kyqe: Deponija, MDT, TIN, GRID, Civil 3D, Kelmendi, Trepça.

¹**Ass.MSc. Edon MALIQI**, edon.maliqi@gmail.com, +37744446128,
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” . Mitrovicë

²**Prof.dr. Edmond HAJRIZI**, ehajrizi@ubt-uni.net,
Universiteti për Biznesë dhe Teknologji. Prishtinë

³**Prof.asoc.Dr. Gani MALIQI**, g_kutllovc@hotmail.com, +37744166044
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” . Mitrovicë

⁴**Ing-Dip. Abdurrahman KULETA**, abdurrahman.kuleta@rks-gov.net +37744141204
Agjencja Kadastrale e Kosovës. Prishtinë



ABSTRACT

The Republic of Kosovo is a famous place with real underground. Along with rich mineral exploitation great importance to the management of mining waste which remain as a result of the processing of minerals. Countries where data collection of this material sterile (barren) called landfill and among some landfills that are in our country is also Kelmend landfill, a place near Mitrovica (Maliqi, 2014).

The aim of this paper is that the submission of digital terrain model dump Kelmend exploiting opportunities that gives us AutoCad Civil 3D software. Submission of digital terrain model dump Kelmendi will become the method TIN and GRID. The software in question has risk methodology for creation DTM .

Creating the MDT of dump Kelmendi is performed in a master thesis of Edon Maliqi under the guidance of mentor Prof.dr.Edmond Hajrizi and cooment Prof.dr. Bashkim Idrizi in University for Business and Technology in Pristina (www.ubt-uni.net). Among the primary goals of the paper is the efficient management of the landfill and positive impact on performance management Trepca mining in certain activities in landfill by creating Digital Terrain Model (DTM) (Maliq, 2014) .

Key words: Landfill, DTM, TIN, Grid, Civil 3d, Kelmend, Trepca.

1. HYRJE

Në kohën të cilën jetojmë, interneti mbetet një prej burimeve të informacioneve të ndryshme për fushatë ndryshme shkencore. Vizatimi i mbështetur në kompjuter siguron softuer, teknika për futjen e të dhënavë, paraqitjen dhe vizualizimin dy dhe tri përmasor. Avancimet në grafikën kompjuterike sigurojnë harduer dhe softuer për observimin dhe paraqitjen e objekteve grafike, teknikat e vizualizimit e të tjera.

Sistemet e menaxhimit të bazës së të dhënavë kontribojnë: në metodat për paraqitjen e të dhënavë në formën digitale (numerike), në procedurat për ndërtimin e sistemit dhe kapjen e vëllimeve të mëdhatë të dhënavë, në sigurimin e futjes dhe në përtëritjen e të dhënavë. Intelekjenca artificial e përdor kompjuterin për të bërë zgjidhjet e bazuara në të dhëna të vlefshme. Kompjuteri mund të veprojë si një “ekspert” në funksione të tillë, si: përpilimi i hartës, përgjithësimin e vutive të hartës e të tjera (Nikolli P, 2007).

Programet e ndryshme kompjuterike ndihmojnë në: për përshtypjen e llogaritjeve, saktësinë, menjanimin e gabimeve të rastit, minimizimin e ndikimit të faktorit njeri, përdorim të shumqëllimshem të të dhënavë, etj. Teknologjia e ndryshme informative gjithashtu ndihmon në kursimin e kohës në raportet me metodat manuale. Gjuhët e ndryshme programuese ndihmojnë në zgjidhjen e detyrave të caktuara në gjeo-shkenca (gjeodezi)



sepse edhe softuerët e ndryshëm profesional janë hartuar me ndihmën e gjuhëve të ndryshme programuese.

Përdorimi i instrumenteve të ndryshme për kolektimin e të dhënavë nga terreni ndihmon që aktivitetet në terren të kryhen më shpejt dhe me saktësi më të lartë. Fjalorët e ndryshëm digjital që gjenden në internet na lehtësojnë konsultimin e litëraturës dhe të kuptuarit e termave nga gjuhët e huaja!

2. SOFTUERI Autodesk - CIVIL 3D

AutoCAD është softuer i aplikuar për të ndihmuar në dizajnimet sa më të lehta kompjuterike ose dixhitale të të dhënavë (cad), si dhe hartimin ose praqitjen e të dhënavës në dy mënyra kryesore: në atë 2D (planimetrike ose dy dimensionale) dhe 3D (naltimetrike ose tredimensionale) (Idrizi, 2009). Ky softuer është ndërtuar dhe zhvilluar nga kompania Autodesk, e fokusuar në dizajnimin e softuerave kompjuterik të cilët mund të përdoren në lëmi të ndryshme, edhe atë në industri e arkitekturë, inxhinieri e ndërtim, industri të prodhimit, media, në fushën e lojrëva të ndryshme etj.

Sa i përket mundësive që oforn kompanian AUTODESK, respektivisht softueri Civil 3d për krijimin e modelit dixhital të lartësive e të terrenit, janë të shumta e të shumëllojshme, duke filluar nga futja e të dhënavës, metodat për paraqitje të modelit dixhital, krijimi i kufijëve të modelit, krijimi i kornizave të ndryshme, krijimi i vijave të thyerjes, krijimi i modelit dixhital nga izohipsat, krijimi i ujëmbledhësve-ujëndarësve, deri te mundësitet e editimit si: eleminimi i linjave, pikave, vendosja e pikave, linjave, modifikimi, zhvendosja e pikave, minimizimi i sipërfaqëve të rrafshta, si dhe mënyra automatike për rregullimin e modelit duke bërë interpolimin e pikave të reja për një përpunim të modelit dixhital të terrenit.

3. DEPONIJA E KELMENDIT⁵

Ndodhet në vendin e quajtur Kelmend, si deponi periodikisht aktive. Gjendet në perëndim të Flotacionit në Tunelin e Parë dhe zë sipërfaqe prej 18ha, ku janë depozituar rreth 3,6 milion tonelata mbetje. Duhet theksuar se në këtë deponi, përpos materialit, deponohet edhe uji që vjen nga miniera Trepça dhe flotacioni. Të gjithë ujërat në deponi përmes impiantit derdhen në lumin Ibër, duke u bërë vetëm trajtimi fizik i tyre (Maliqi, 2014). Zona/lokaliseti ku ndodhet deponia karakterizohet me këtë ndërtim gjeologjik: brekçe

⁵Kelmend quhet vendi ku ndodhet deponija

vullkanike kuarlatite, andezite dhe tufe të neogenit, formacioni diabaz-stralor i jurasikut si dhe rreshpe gëllqerorë të triasikut dhe paleozoikut. Edhe pse deri më tanë janë bërë disa punime për trajtimin e kësaj deponie, ajo mbetet rrezik i madh si për banorët, ashtu edhe për mjedisin jetësor.



Foto 1. Pamje e deponisë së Kelmendit (Burimi: MZHE, 2013)

4. MBLEDHJA E TË DHËNAVE BURIMORE-HYRËSE

Në erën dixhitale, mbledhja e të dhënavëve për krijimin e MDT bëhet me ndihmën e GPS-it, metoda fotogrametrike, remote sensing nga platformat satelitore nga rrjedhin metodat LIDAR dhe RADAR etj (Maliqi, 2014). Për ndërtimin e MDT të deponisë janë shfrytëzuar të dhënat e ekzistuese në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës dhe në Minierën Trepça në Stan Tërg. Të dhënat e shfrytëzuara janë:

- izohipset në formën vektoriale,
- koordinatat përkufizese të lokacionit të deponisë, dhe
- modeli dixhital i terrenit i krijuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) me rezolucion hapësinor 10cm (Maliqi, 2014).

5. KRIJIMI I SIPËRFAQEVE DIXHITALE TË TERRENIT PËR DEPONINË E KELMENDIT

Në përgjithësi ekzistojnë dy metoda dixhitale për modelimin e reliefit, edhe atë: rrjeti i rregullt i trekëndëshave (TIN-triangulated irregular network), rrjet (grid) i rregullt i pikave dhe kombinimi i tyre me pikat karakteristike të terrenit. Kur krahas kualitetit të paraqitjes së reliefit në hartë faktor i rëndësishëm paraqitet efikasiteti në punë, modeli digital duhet të formohet me ndihmën e grid-it (rrjetit) i plotësuar me të dhëna për pikat e rënies së terrenit (vijat ujëmbledhëse dhe ujëndarëse), respektivisht I ashtuquajtur grid i kombinuar.

Duke pasur parasysh kërkeshat për modelim me saktësi të lartë gjatë punimeve inxhinierike, si dhe duke pasur parasysh karakteristikat e cekura



më lartë, MTD-ja paraqet metodë të pazëvendësueshme për formimin e modelit tredimensional të terrenit. Kjo metodë në të njëjtën kohë mundëson formimin e modelit tredimensional në formë digjitale dhe saktësi të lartë të koordinatave-kuotave të pikave detaje në të!

5.1. Krijimi i TIN-it

Me shfrytëzimin e opsjoneve që ofron Civil 3D, duke importuar pikat në faqen punuese të Civil 3D, u krijua sipërfaqja

TIN	
Number of triangles	4319
Maximum triangle area	600.36sq.m
Minimum triangle area	200.12sq.m
Minimum triangle length	20.006m
Maximum triangle length	145.646m

TIN⁶, përkatësisht MDT-ja me metodën TIN. Kualiteti i TIN-it është i lartë, pasi që dendësia e pikave të shfrytëzuara për krijimin e TIN-it është në distancë mesatare 35m, prej të cilave u krijuan 4319 trekëndësha me sipërfaqe ndërmjet 200-600m² dhe gjatësi të brinjëve ndërmjet 20-145.6m. Si rezultat i editimit të TIN-it, është siguruar saktësi më e lartë e TIN-it, e cila grafikisht mund të shihet në figurën 2 ku është paraqitur një pjesë karakteristike e deponisë. Shfrytëzimi i opsjonit “Boundaries” ka mundësuarpërcaktimin e kufirit të deponisë, ndërkaq me funksionet “Swap Edge” dhe “Delete line” janë zhvendosur/fshirë brinjët e linjave të trekëndshave në sipërfaqet ku trekëndshat paraqesin figura të pa logjikshme, proces që ndikoi në rritjen e kualitetit të TIN-it të krijuar. Përparësia e kësaj metode krahas metodës Grid është se kjo metodë mundëson ndërhyrjen manuale në TIN-in e krijuar, me qëllim të paraqitjes së pjesëve karakteristike të terrenit.



Fig.1 . Paraqitja e pikave të importuara në hapsirën e fakes punuese




Fig. 2. Modeli dixhital i terrenit me Boundaries

⁶Triangulated Irregular Networks

5.2. Krijimi i GRID-it

Sipërfaqja Grid është krijuar me dimensione 1x1m, respektivisht me rezolucion hapësinor 1m. Duke u referuar në të dhënët ekzistuese burimore,

Revision number	0
Number of points	2209
Minimum X coordinate	7489406.822m
Minimum Y coordinate	4751635.633m
Maximum X coordinate	7490927.278m
Maximum Y coordinate	4752695.951m
Minimum elevation	513.000m
Maximum elevation	703.000m
Mean elevation	606.530m

rezolucioni hapësinor i përdorur në këtë punim është i përshtatshëm për të siguruar një pamje sa më të reale të deponisë. Grid-i i krijuar duket si sipërfaqe për shkak të numërimit të madhë të pikave përkatësisht dendësishë së katorëve (fig.3). Paraqitura e një pjese të grid-it, mund të vërehet në figurën 4 ku me zmadhim të pamjes është arritur qartësia e paraqitjes grafike të pikave në grid. Modeli i krijuar përlrmban gjithsej 2209 pika në distancë 1m, me kuota ekstreme 513m dhe 703m, dhe lartësi mesatare mbidetare prej 606.5m.



Fig. 3. Paraqitura e sipërfaqes Grid në faqen punuese




Fig. 4. Paraqitura e sipërfaqes Grid në pamje më të zmadhuar

5.3. Krijimi i sipërfaqes së vëllimit

Njehsimi i vëllimit është realizuar me pesë metodat që ofron softueri i përdorur Civil 3d. Nga sipërfaqet dixhitale të krijuara me metodat TIN dhe GRID, të dyperiudhave të ndryshme kohore, u njehsuan vëllimet sipas metodës së TIN-it hapësinor, GRID-it hapësinor, si dhe metodës së profileve tërthore. Metoda e GRID-it hapësinor, që të ketë mundësinë e krashtimit, u krijuar me tre rezolucionë hapësinore, edhe atë me 1m, 5m dhe 10m.

Metoda e profileve si metodë më klasike në krashtim me dy të parat, u realizua me tre metodologjitet e njehsimit të ofruara nga Civil 3d, respektivisht sipas metodave kompozite, prismoidale dhe sipërfaqet mesatare. Nga njehsimet e realizuara në formë automatike në softuer, u fituan shtatë vlera të vëllimit, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Metoda TIN	137960.15 m3	
Metoda GRID	1x1 m	137740.13 m3
	5x5 m	136890.55 m3
	10x10 m	135673.71 m3
Metoda e Prerjeve Tërthore (çdo 5m)	Compozite Volum	137767.12 m3
	Prismoidal	137905.07 m3
	Average End Area	137866.26 m3

Tabela 4. Tabela e përgjithshme e vëllimeve

6. PËRFUNDIME

Ky MDT mund të shfrytëzohet për punë të ndryshme shkencore. Nga punimi është vërejtur se krijimi i MDT me metodën TIN ka nevojë për ndërhyrje manuale në formimin e trekëndësheve, ndërkaq saktësia e metodës GRID kryesisht varet nga dimensionet e katorrëve. Gjithashtu Autocad Civil 3D jep mundësi të shumta për paraqitje të modelit dixhital të terrenit dhe ky model mund të shërbejë për punë të ndryshme profesionale si llogaritje të vëllimit, paraqitje të profileve të ndryshme etj.

Në figurën e mëposhtme shihet paraqitja e reliefit me metodën e izohipsave, të gjeneruara në formë automatike me softuerin në fjalë dhe modelin dixhital të terrenit.




Fig. 5. Paraqitja e sipërfaqes reliefit me metodën e izohipsave dhe kuotave

Pas realizimit të llogaritjeve, kemi ardhur në përfundim se të gjitha metodat e përdorura për njehsimin e vëllimit në deponi janë rezultate të ndryshme. Duke u nisur nga fakti se e llogaritjes saktësia e vëllimit të njehsuar me metodën Grid varet nga dimensionet e katorrit me të cilën krijohet sipërfaqja Grid, nërastin tonë janë përdorur dimensionet 1x1m, 5x5m dhe 10x10m. Sa



më e vogël që është distanca në mes pikave, aq më e madhe është edhe saktësia vëllimit të llogaritur, dhe e kundërtë.

Edhe në rastin e llogaritjes së vëllimit me metodën e prerjeve tërthore në kuadër të së cilës bëjnë pjesë metodat Kompozite, Prizmoidale dhe ajo e Sipërfaqeve mesatare, janë fituar rezultate të ndryshme njëra prej tjetës. Distanca ndërmjet profileve tërthore është pranuar të jetë çdo pesë metra.

Nga diversiteti i vlerave të njehsuara dhe analiza krahasimtare e tyre, metodat TIN dhe GRID me 1m paraqesin metodat me saktësi më lartë në krahasim me të tjerat! Dallimi prej rreth 15% nga vlera e përgjithshme të vëllimit, vjen si rezultat i sipërfaqeve të përdorura dhe saktësisë së të dhënavë burimore.

Me formimin e modeleve dixhitale trepërmasore për deponinë e Kelmendit, u krijuva vija zero-bazë për njehsimet në periudhën që pason. Krahas formimit të modeleve dixhitale dhe njehsimit të vëllimit, misioni i projektit ishte inkudrimi i proceseve automatike dixhitale në punën e përditshme për menaxhim me Deponinë e Kelmendit.

7. Literatura

- Idrizi, B. (2009). *Topografia*. Shkup.
- Maliqi, E. (2014). *Përdorimi i modelit dixhital të terrenit në civil 3d për llogaritjen e vëllimit në deponinë e Kelmendit (punim masteri)*. Prishtinë.
- MZHE (2013). *Mundësítë dhe mënyrat e ri kultivimit të deponive dhe vendburimeve të shfrytëzuara minerale - Projekt*.
- Anon, (2014). [online] Available at:
<http://education.usgs.gov/lessons/dem.pdf> [Accessed 19 Oct. 2014].
- Anon, (2014). [online] Available at:
<http://c.ymcdn.com/sites/www.njspls.org/resource/resmgr/Docs/TerrainModelingContouringAna.pdf> [Accessed 20 Oct. 2014].



Micro, Macro & Mezzo Geo Information	
ISSN	1857-9019
Country	Macedonia
Frequency	2 issues per year
Year publication	2013
Website	http://www.mmm-gi.blogspot.com/
Global Impact Factor	
2013	0.386

<http://globalimpactfactor.com/micro-macro-mezzo-geo-information>

REVISTA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

Mikro Makro & Mezo

Gjeo Informacione

ISSN: 1857-9000 (versioni i printuar)

ISSN: 1857-9019 (versioni elektronik)

Impakt faktor (2013): 0.386

<http://mmm-gi.blogspot.com>

- Revistë ndërkombëtare bazuar në Ligjin për arsim të lartë të Maqedonisë;
- E regjistruar në Bibliotekën kombëtare dhe universitare të Maqedonisë "Shën Kliment Ohridski" Shkup me numër ISSN;
- E regjistruar në sistemin ndërkombëtar Impakt Faktor;
- Revistë periodike, me botim të dy vëllime në një vit kalendarik;
- Lloje të artikujve: punime shkencore, punime profesionale, ekspoze, intervista, recensione, in-memoriam, lajme për ngjarje dhe literaturë profesionale-shkencore;
- Publikimi: botim në letër në 200kopje dhe në formë elektronike në ueb faqe me qasje të hapur dhe falas për të gjitha punimet;
- Gjuhët zyrtare të revistës: Shqip dhe Anglisht;
- Gjuha e punimeve: Shqip ose Anglisht.

TEMAT: gjeodezi, gjeofizikë, hartografi, gjeografi, geostatistikë, toponomastikë, gjeologji, gjeomorfologji, gjeodinamikë, gjeopolitikë, hidrologji, demografi, sigj, idhh, kadastër, topografi, gjeoinformatikë, teledetekcion, fotogrametri, miniera, pylltari, tokë, klimatologji, mjedisi jetësor, planifikimi urban dhe hapësinor, ekologji, të dhëna gjeohapësinore, gjeo shkencat tjera.

CMIMI PËR PUBLIKIM:

Punim deri 5 faqe: 50euro

Punim deri 10 faqe: 100euro

Punim deri 15 faqe: 150euro

SPONSORIMI I REVISTËS

Faqja e fundit - kopertina: 300euro

Një faqe të plotë: 150euro

Gjysëm faqe: 100euro

Logo dhe ueb faqe: 50euro



Gjeo Informacione



Geo Information

INTERNATIONAL SCIENTIFIC JOURNAL

Micro Macro & Mezzo

Geo Information

ISSN: 1857-9000 (printed version)

ISSN: 1857-9019 (electronic version)

Impact Factor (2013): 0.386

<http://mmm-gi.blogspot.com>

- International journal based on the Law for high education of Macedonia;
- Registered in National and university library "St. Clement of Ohrid" – Skopje with ISSN number;
- Registered in international system of Impact Factor
- Periodical journal, with two volumes published within one calendar year;
- Type of articles: scientific papers, professional papers, overview, interviews, reviews, in memoriam, news for professional-scientific events and literature;
- Publication: publishing as hard copy in 200copies, and as free accessible electronic version in journal web site;
- Official journal languages: English and Albanian;
- Language of articles: English or Albanian.

TOPICS: Surveying, Geophysics, Cartography, Geography, Geostatistics, Toponomastic, Geology, Geomorphology, Geodynamics, Geopolitics, Hydrology, Demography, GIS, SDI, Cadaster, Topography, Geoinformatics, Remote sensing, Photogrammetry, Mining, Forestry, Soils, Climatology, Environment, Spatial and urban planning, Ecology, Geo-spatial data, other geo sciences.

FEES:

Paper up to 5 pages: 50euro
Paper up to 10 pages: 100euro
Paper up to 15 pages: 150euro

SPONSORSHIP

Last cover page: 300euro
Full page: 150euro
Half page: 100euro
Logo and web adress: 50euro



Gjeo Informacione



Geo Information

SUBMISSION FORMAT OF PAPERS

Format: As defined by the template ([Template_Paper.docx](#)). One line space between the text and heading title, two line spacing between text and heading title, and one line space between text and subheading/sub-subheading title.

Size: up to 15 pages, and up to 15MB.

Language: English or Albanian

Title: Font 12pt, Times New Roman, with capital letters, bold, in center, and single spacing. The title needs to be written in second line (one space line 12pt).

Name of the author/s: Font 11pt, Times New Roman, name with first capital letter, surname with all capital letters, bold, in center, after surname add footnote with number, single spacing, all authors in one line. Between title and name of the author, leave one line spacing with 11pt.

Affiliations: To be written in the footnote, single spacing, font 8pt Times New Roman, in the order: degrees, Name, SURNAME (all in bold), e-mail address, new line and four space characters, institution, web address, new line and six space characters, telephone, gsm and fax numbers, new line and four space characters, address. No line spacing between footnotes.

Abstract title: With upper case letters, bold, font 11pt, Times New Roman, left text, without space in the beginning of the line, single spacing. Between title of abstract and name of the authors, two line spacing with 10pt.

Text of abstract: Font 10pt, Times New Roman, justified, single spacing, without space in the beginning of the line. The text of abstract should contain maximum 300 words (counted by “word count-no spaces”). Between the title and text of abstract, leave one line space with 9pt.

Key words: Font 11pt, Times New Roman, justified, single spacing, without space in the beginning of the line. Between the key words and text of abstract, one line spacing with 9pt.



Headings: With upper case letters, bold, font 11pt, Times New Roman, left text, without space in the beginning of the line, single spacing and numbered.

Subheadings: Bold, font 11pt, Times New Roman, left text, without space in the beginning of the line, single spacing and numbered according to number of heading.

Sub-subheadings: With bold and italic characters, font 11pt, Times New Roman, left text, without space in the beginning of the line, single spacing and numbered according to number of subheading.

Text of paper: Font 11pt, Times New Roman, justified, single spacing, without space in the beginning of the line. The text should include the Introduction as a first and Conclusions as a last chapter.

Tables: Head of the table, above the table, with font 10pt, Times New Roman, italic. Tables should be numbered consecutively throughout the paper. Table to be in center, with font 10pt, Times New Roman, single spacing. Between title of table and table, one line spacing with 10pt. All tables must be cited in text.

Figures/maps: Figures-maps should be numbered consecutively throughout the paper. After figure/map, its title must be written, with font 10pt, Times New Roman, italic. Between title of figure/map and figure/map, leave one line space with 10pt. All figures/maps must be cited in text.

Symbols and special characters: Use the SI (Systeme Internationale) units and symbols.

References: The Harvard referencing system is to be used. Footnotes should not be used.

<http://mmm-gi.blogspot.com>

*South-East European Research Institute on Geo Sciences
“Geo-SEE Institute”*

adress: str. Djon Kenedi, 25/1-d3; 1000 Skopje, Macedonia.

tel: + 389 2 6140-453; gsm: + 389 75 712-998

info.geosee@gmail.com, www.geo-see.org



DETAILS FOR INTERNATIONAL PAYMENTS

Bank name	Komercijalna Banka AD Skopje Branch office: Chair, Skopje
Bank address	Str.Ferid Bajram, 48 1000 Skopje Macedonia (FYRoM)
SWIFT	KOBSMK2X
Beneficiary – account holder	Geo-SEE Institute (South East European Research Institute on Geo Sciences)
Beneficiary address	Str Djon Kenedi, 25/1-d3 1000 Skopje Macedonia
IBAN	MK07300701003027046
Remittance information	For paper publishing in journal MMM-GI.
Details of charges	OUR (Full amount for international bank transfer should be covered by the author/s of paper/s)

DETAILS FOR NATIONAL PAYMENTS

Образец	ПП10 за физички лица; ПП30 за правни лица.
Назив и седиште на примач	Гео-СЕЕ Институте, Ул.Џон Кенеди, 25/1-д3, 1010 Скопје-Чаир
Трансакциска сметка на примач	300-0000036339-47
Банка на примач	Комерцијална Банка АД Скопје
Шифра	930
Цел на дознака	Научен труд за објавување во списание



micro
macro
geo

Geo Information

micro
macro
geo

Geo Informacione

